



QENDRA PËR HULUMTIM DHE KRIJIM TË POLITIKAVE





Analizë e shkurtër nr.17

VETO MAQEDONISË FITORE E NACIONALIZMIT GREK DHE SI MË TUTJE

- Prill, 2008

Center for Research and Policy Making
Mirche Macan bb st
1000 Skopje, Macedonia
T: +389 3 216 646 F: +389 3 216 645
www.crpm.org.mk | crpm@crpm.org.mk





Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave është institut i pavarur hulumtues dhe joprofitabil i themeluar si rezultat i nevojës për hulumtime të pavarura, thelbësore dhe të sakta në fushën e aplikimit të politikave (publike). QHKP krijon analiza si dhe mbikqyr procesin e krijimit të politikave në Maqedoni. Me hulumtimet e veta dhe analizat objektive përpiqet të krijojë debat rreth çështjeve të rëndësishme socio-ekonomike për Maqedoninë. QHKP përbëhet nga grup ekspertësh nga vendi si dhe bashkëpunorë të jashtëm nga vende të ndryshme Europiane. Ekspertët janë të arsimuar dhe kanë përvojë në lëmi të ndryshme, si psh politikologjia, juridiku, ekonomia, marrëdhënie ndërkombëtare dhe sociologji.

QHKP ka për qëllim plotësimin e dallimit ndërmejt , zgjidhjeve ligjore, politikave publike dhe situatës reale nëpërmjet situatave konkrete si dhe lobimit (advocacy) .

Fushat në të cilat anëtarët e QHKP-së momentalisht punojnë janë :

- a) Zhvillim socio-ekonomik të komunave
- b) Hulumtim të skenës politike në Maqedoni nëpërmjet sudimeve të opinionit publik të ashtuquajtura Studime Para dh Pas Zgjedhjeve (national election studies në Universtitetin në Michigan)
- c) Hulumtime në Shëndetsi dhe Mbrojtje Shëndetsore (financim, racionalizim të shërbimeve shëndetsore dhe të ashtuquajtura quality assurance)
- d) Sigurim social (sisteme pensionale)
- e) Qeverisje të mirë (monitoring të decentralizimit në nivel lokal)
- f) Ndërtim të kapaciteteve të OJQ-ve, grupe të qytetarëve dhe organizata profesionale nëpërmjet trajnimeve për atë se si realizohen hulumtimet të politikave publike (policy analysis)
- g) Procese eurointegrative
- h) Evaluim të efikasitetit të politikave publike, rregullativave dhe ligjeve

Mendojmë se përgaditja e studimeve të rastit për problemet socio-ekonomike të Maqedonisë në mikro nivel do ta ndihmojë procesin e krijimit të politikave publike të mira respektivisht kualitative. Gjithashtu jemi të bindur që është më shumë se e nevojshme të punohet drejt evaluimit të politikave publike nëpër sektore të ndryshme që të njëjtat të kenë përmirsim dhe të jenë më afër nevojave të qytetarëve

Sipas enciklopedisë Britanika fillimisht “Europa” është llogaritur si “Sipërfaqe toksore” përshkrimin i përshtatshëm i shteteve më veriore të zhvilluara të cilat zgjaten diku më larg, shtete me karakteristika të veta por jo aq të njohura... tërësisht të ndryshme nga konceptet si Azia dhe Libia, që të dyjat relativisht prosperuese të cilat janë në kontakt të afërt me kulturën e Helenëve dhe parardhësve të tyre. Ndër shtetet të cilat gjindet ne veri të Greqisë sot është edhe Republika e Maqedonisë.

Maqedonisë, para disa kohësh nuk i ishte dhënë ftesë për anëtarim në NATO për shkak të vetos greke. Në Samitin e NATO-s të mbajtur në Bukuresht, liderët aktualisht refuzuan të dërgojnë ftesë për anëtarim në alijansën pasi që Greqia e bllokoi vendimin për shkak të emrit të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë¹. Sekretari Gjeneral i NATO-s, Jan De Hop Shefer në konferencën për shtypin tha:”Ne u pajtuam që ftesa ti dërgohet Ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë menjëhere pasi që të arritet zgjidhje e përbashkët e pranueshme për çështjen e emrit “.

Qëndrimi oficial i Minsitrisë të Punëve Jashtme të Greqisë thotë që është e “pamundur ti lejohet IRJM hyrje në EU dhe NATO me emrin Republika Maqedonisë” dhe se “Slavomaqedonasit e IRJM-së insistojnë edhe më tutje qëndrim e tyre këmbëngulës negativ në drejtim të zgjidhjes të çështjes së emrit “². Sipas Ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, Dora Bakojani, emri “Republika e Maqedonisë”... është e lidhur me plan pregaditor për përvetsim të teritorit grek, që ka identitet grek më shumë se tre mileniume dhe gjithashtu është e ndërlidhur me shumë dhimbje dhe sakrificë të popullit grek³.

1 <http://www.reuters.com/article/topNeës/idUSL0327252820080403>, On the Greek veto see also <http://www.ana-mpa.gr/anaëeb/user/shoëplain?maindoc=6305115&maindocimg=6305032&service=6>

2 <http://ëëë2.mfa.gr/ëëë.mfa.gr/en-US/Policy/Geographic+Regions/South-Eastern+Europe/Balkans/Bilateral+Relations/FYROM/FYROM+-+THE+NAME+ISSUE.htm>

Athina insiston Shkupi të përdorë emër të përbërë si Maqedonia “E epërme” ose “E re”

Kërkesa që Maqedonia ta kundërshtojë veten, në fakt është pa presedan dhe pas asnjë arsytim. Fakt që “kontesti” rreth emrit është eufemizëm ndaj vërejtjeve greke, ndonjëherë direkte dhe të hapura e ndonjëherë indirekte dhe të mbyllura , drejt vetegzistimit të shtetit Maqedonas dhe popullit. Grekët përdorin emra si “sllavomaqedonas” “shkupjan”⁴, “ BJRM” dhe “ popull BJRM”⁵ të cilat janë thyerje etnike dhe të cilat janë mosrespektim i plotë i të drejtave dhe vlerave njerëzore nga ana e grekëve. Ato janë thyerje të njëjta si “ zezak (niger) të cilat përdoren në kontekst ofendues racor kundër afro-amerikanëve .Për fat të keq, në rastin e politikës së jashtme të Greqisë për Maqedoninë dhe maqedonasit, pamë se jo vetëm bashkësia akademike por edhe bashkësia ndërkombëtare i mbyllte sytë ndaj histerisë raciste drejt pranimit të Republikës së Maqedonisë ne Kombet e Bashkuara në fillim të viteve 90-ta si dhe sot në NATO.

Politika e jashtme e Greqisë ndaj Maqedonisë është rezultat i ideologjisë të nacionalizmit etnik i cili dominon në shoqërinë greke që nga formimi i saj. Greqia e kundërshton egzistimin e kombit maqedonas si dhe të pakicës maqedonase në territoret e Greqisë për arsye që pranimi i tillë do të ishte i kundërt me përrallat e homogjenisë-etnike dhe pastërtsisë të cilat e definojnë nacionalizmin etnik grek.⁶ .Maqedonasit nuk mund të egzistojnë nga arsya e vetme çdo kush që nuk është Grek nuk mund të egzistojë në kuadër të Greqisë. Në Greqi si dhe në të shumtën e shteteve ku dominon nacionalizmi etnik,

3 <http://ëëë.iht.com/articles/2008/03/31/opinion/edbakoy.php>

4 <http://ëëë.ana-mpa.gr/anaëeb/user/shoëplain?maindoc=6284332&maindocimg=6267967&service=10>

5 <http://ëëë2.mfa.gr/ëëë.mfa.gr/en-US/Policy/Geographic+Regions/South-Eastern+Europe/Balkans/Bilateral+Relations/FYROM/FYROM+-+THE+NAME+ISSUE.htm>

6 Takis Michas, *The Unholy Alliance: Greece and Milosevic's Serbia during the 1990s*, Texas A & M University Press, 2002.

“e drejta në egzistim “ si dhe çdo e drejtë tjetër , del nga përkatësia e personit kah grupi etnik dominues e jo nga pjesëmarrja në veprimtarinë politike/ pagesa e tatimeve ndaj shtetit/ respektimi i kushtetues dhe shtetit.

Maqedonia ka të drejtë legjitime në emër dhe identitet. Kjo e drejtë bazohet në më shumë argumente dhe atë juridike, morale, historike ose thjesht argumente të bazuara në ide liberalo demokratike. Vetëpërcaktimi është princip që konsiderohet si e drejtë morale dhe ligjore se “ të gjithë njerëzit kanë të drejtë ta shprehin statusin e tyre politik dhe lirshëm ta realizojnë zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor”⁷ Në vjeshtën e 1991, pas verës me plotë konflikte fillimisht në Slloveni, pastaj nëpër tërë Kroacinë, Maqedonia e shfrytëzoi të drejtën e saj në vetëpërcaktim. Më 8 Shtator të vitit 1991 u mbajt referendumi ku më shumë se 95% votuesish votuan për shtet Sovran dhe të pavarur. Thirrja në referendumin ishte tejet e madhe -76%.⁸

E drejta në përcaktim, etnik, nacional dhe e drejta në identitet janë princip themelore të drejtës nërkombëtare, postulate themelore të rendit ndërkombëtar. Egzistimi i kombit... është plebishit ditor ashtu si edhe egzistimi personal është afirmim i vazhdueshëm i jetës.⁹ .Sot, edhe përveç presionit grek, hulumtimet tregojnë se qytetarët e maqedonisë me shumicë (83%) nuk duan ta ndrojnë identitetin e tyre dhe emrin e shtetit qoftë edhe për anëtarim në NATO¹⁰

7 Меѓународна спогодба за граѓански и политички права, член 1. maqedonist

8 Види резултатите од референдумот во *Уставно право*, Унион Трејд, Скопје, 1994 година, стр.359, стр..376-380.

9 Што е тоа нација? (Qu'est-ce qu'une nation?) Ernest Renan, Geoff Eley и Ronald Grigor Suny , издание 1996. *Becoming National: A Reader*. Neë York and Oxford: Oxford University Press, стр. 41.

Në vitin 1991 si edhe në vitin 2008 Maqedonët e vërtetuan egzistimin e kombit , ajo nuk mund të vihet në pikpytje.

Shikuar historikisht, Greqia nuk kishte vërjetje për emrin e fqijt të saj verior në kohën e Jugosllavisë. Nga viti 1944 deri në vitin 1991, Republika Popullore e Maqedonisë “(ndërsa më vonë “Republika Socialiste e Maqedonisë”) ishte një ndër gjashtë republikat konstitutive të bashkimit të shteteve Jugosllavisë. Pasi që ajo u shkatërua , duke e përdorur fuqinë e saj, Greqia bllokoj njohjen ndërkombëtare të Republikës edhe përveç faktit se në vitin 1992 Maqedonia i përmbushi të gjitha kushtet të cilat i përcaktoi Bashkimi Europian¹¹.

Për ta kënaq kujdesin dhe mërzin Greke se emri i shtetit implikon (ojka) tendenca territoriale ndaj Greqisë, Maqedonia miratoi dy amendamente në Kushtetutë (6 Janar 1992). Ata thonë se Maqedonia” nuk ka tendenca territoriale kundër asnjë shteti fqij”; dhe se kufijt e saj mund të ndryshohen vetëm në pajtim me Kushtetutën dhe “ normat e përgjithshme ndërkombëtare të pranauara” dhe se në kujdesin për pozitën dhe të drejtat e qytetarëve të saj dhe pakicës nëpër shtetet fqinje “ajo nuk do të merr pjesë në të drejtën sovraane të shteteve tjerë dhe të çështjeve ndërkombëtare të tyre”. Maqedonia i pranon kufijtë egzistues dhe nuk ka tendenca territoriale kundër asnjë nga fqinjët e vet. Edhe nëse nacionalistë të caktuar ekstrem maqedonas ëndërrojnë ose flasin për Maqedoni të Madhe , shteti nuk posedon asnjë lloj mjetesh të cilat do të ishin rezik për për fqijt e vet, status kuon egzistuese territoriale. Maqedonia në mënyrë publike, formale dhe vazhdimisht potencon se nuk ka kurrfarë tendenca territoriale kundër Greqisë.

Maedonisht

10 Види резултатите од истражувањето на <http://ëëë.crpm.org.mk/Papers/Surveys/Changing%20the%20name%20or%20NATO%20membership.htm>

11 Во својот Извештај од 15 јануари 1992 година, Европската арбитражна Комисија, предводена од Роберт Бадентер, го искажа мислењето дека Македонија и Словенија во целост ги исполнуваат условите за независност и меѓународно признавање, согласно критериумите кои се однесуваат на меѓународно признавање на државите наследнички на СФРЈ, содржано во Декларацијата на Европската заедница од 16 декември 1991 година. Спротивно на оваа препорака, признавањето беше одложено поради противењето од Грција, со објаснување дека името Република Македонија, наводно, е закана за нејзиниот територијален интегритет и присвојување на хеленското културно наследство.

Pranimi i Maqedonisë në Kombet e Bashkuara në Prill të vitit 1993 me Rezolutën 47/225 (1993) e sjellur nga Kuvendi i Përgjithshëm u rregullua me dispozitë se “shtetit provizionisht do të komunikojnë për të gjitha qëllimet në kuadër të Kombeve të Bashkuara me Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, në pritje të zgjidhjes të dallimeve të cilat dolën rreth emrit të shtetit”. Nën shtypje, deri më tani të gjitha qeveritë maqedonase u pajtuan të marrin pjesë në proceset e KB dhe në proceset për gjetjen e zgjidhjes eventuale në” kontestin për emrin”.Negociojnë edhe përshkak faktit se kushtet shtesë paraqesin shkelje të ligjit 4(1) nga Deklarata e Kombeve të Bashkuara, të interpretuara nga Mendimi Sygjerues i Gjyqit Ddërkombëtar të Drejtësisë, më 28 Maj 1948, (e cila është pranuar me rezolutën 197/III në Kuvendin e Përgjithshëm në vitin 1948) ¹²

Preambula e Rezolutës 817 e Këshillit të Sigurisë me anë të cilës Maqedonia qe rekomanduar për pranim në OKB, pranon se “shtruesi i kërkesës i përmbush të gjitha kriteret për anëtarim në pajtim me nenin 4 nga Deklarata të Kombeve të Bashkuara”. Sipas Rezolutës 197 për pranim të shtetit në OKB dhe në Kuvendin e Përgjithshëm, kjo do të thotë, parashtruesi i kërkesës ka përmbushur të gjitha kërkesat për anëtarim në Kombet e Bashkuara dhe se nuk mund të nënshtrohen asnjëfar kërkesësash tjera.¹³ Anulimi i pjesës (b) nga Rezoluta 47/225 (1993) e Kombeve të Bashkuara mund të bëhet me rezolutë të re e cila poashtu do ta vërtetojë emrin kushtetues të Maqedonisë në sistemin e Kombeve të Bashkuara.

12 Види трудот на Игор Јанев „Правните аспекти на употребата на провизорното име за Македонија во системот на Обединетите Нации “,” *American Journal of International Law* 93 (1): 155-160, 1999, и „Правната одговорност на Обединетите нации поради незаконскиот прием на Македонија во членство на Обединетите Нации“, *Macedonian Affairs* 3 (1): 53-88, 2001.

13 Исто.

Në atë kohë Qeveria e Maqedonisë fuqishëm u kundërvu përdorimit të emrit provizor, duke thënë se “nën asnjë kusht” nuk është e gatshme ta pranojë atë emër provizor për shtetin. Por, teksti i rezolutës mbeti i pandryshuar dhe negociatat zgjatën deri në Shkurt 1994 kur Qeveria Greke vendosi embargo tregtare Maqedonisë. Dy muaj më vonë, Komisioni Europian “kërkoj nga Gjykata Europiane e Drejtësisë ta vërtetojë embargon Greke si shkelje serioze e të Drejtës së Unionit Europian”. Greqia dhe Maqedonia i normalizuan marrëdhëniet bilaterale me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkohshme, më 13 Shtator të vitit 1995 në Njujork.

Në pajtim me marrëveshjen, Athina u pajtua ta ndëpres ndalesën e njëanshme ndaj fqiu verior të saj ndërsa Maqedonia bëri ca lëshime për vullnet të mirë - heku dorë nga dielli me 16 krah, simbol i flamurit të parë të Maqedonisë të pavarur për të cilën Greqia tha se ka të drejta historike dhe ndryshoi ligjin 3 nga Kushtetua cili thotë se “nuk ka tendenca teritoriale ndaj shteteve fqinje” Që të dy shtetet u pajtuan ti vazhdojnë negociatat nën organizim të Kombeve të Bashkuara ndërsa Greqia u pajtua mos ta pengojë Maqedoninë në pranimin e saj nëpër organizata dhe trupa ndërkombëtare përderisa ajo pranon ti drejtohet me emrin provizor e cila shfrytëzohet në Kombet e Bashkuara¹⁴. Kjo ia çeli derën Maqedonisë të jetë anëtare në organizata dhe incijativa ndërkombëtare duke i përfshirë këtu edhe Këshillin e Europës, OBSE dhe Partneritetin për Paqë.

14 Членот 11 вели: 1. По стапувањето на сила на Времената спогодба, Првата страна се согласува да не го попречува барањето за прием или членството на Втората страна во меѓународни, мултилатерални и регионални организации и институции во кои членува Првата страна. Сепак, Првата страна го задржува правото да не се согласи на членствата во овие организации доколку на Втората страна и’ се обраќаат во тие институции или организации на начин поинаков од ставот 2 од Резолуцијата 817 (1993) на Советот за безбедност на Обединетите нации.

Në Bukuresht, Greqia vendosi veto për ta ndalë ftesën Maqedonisë për anëtarim në NATO. Greqia e shkeli Marrëveshjen e Përkohshme. Edhe më shumë, Athina u kërcnua se do ta shfrytëzojë anëtarimin e vet në BE që të ndikojë në negociatat për hyrje të Maqedonisë. Kjo është sjellje e papërgjegjshme dhe e njëjta duhet ndaluar. Intervnimet se Maqedonia duhet gjetur zgjidhje për çështjen e “kontestit për emrin” është intervenim për Shkupin, që të pranojë ndryshime për emrin dhe identitetin, hap të cilën asnjë qeveri maqedonase nuk do ta bëjë që të mos jetë e akuzuar për tradhëti. Solidarizimi me nacionalizmin grek sjell deri aty se Kriteret e Kopenhages nuk janë të rëndësishme për qasjen e Maqedonisë në BE, se faktor më i rëndësishëm është ndonjë kriter shtesë e cila nuk të bëjë me demokracinë ose sundimit e të drejtës. Opinioni publik do të kthehet kundër Bashkimit Europian. Nacionalizmi dhe etnocentrizmi do të jenë në zhvillim. Si rezultat i gjithë kësaj, qeveria e tanishme ose cilado qeveri e ardhshme e Maqedonisë nuk do të ketë stimul të vazhdojë me reformat e nevojshme.

Nga ana tjetër, përkrahje nga BE ndaj politikës Maqedonase do të zvogëlohet. Edhe më e rëndësishme, që mundësitë për mediacion “të qetë” në kontestet maqedono-shqiptare do të zvogëlohen. Nacionalizmi maqedonas do të rritet por gjithashtu do të rritet dhe ai shqiptar. Radikalët tek shqiptarët gjithmonë kanë qenë inicuar, veçanërisht tash pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe pranimin të saj.

Përkrahja e pozicioneve greke do të jetë sinjal i të gjithë nationalistëve nga Ballkani se Maqedonia ende nuk është shtet “normal” ose shtet që nuk ka ardhmëri të sigurt dhe prosperitet në BE.

Pavarsia e Kosovës dhe kundërshtimi i Serbisë më vetëm e komplikojnë gjendjen në Ballkan dhe se BE-së nuk i është e duhur edhe një krizë. Stabiliteti i Maqedonisë është e rëndësishme substanciale për shkak se çfarëdo lloj konflikti mund të sjell përfshirjen e Turqisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë. Për momentin Shtetet e Bashkuara plotësisht e kuptojnë këtë dhe për atë premtojnë përkrahje Maqedonisë. Tash është kohë e vërtetë për të bërë diçka më shumë. Kundërshtimi për egzistencën e maqedonasve dhe shtetit të tyre nuk ndihmon në zgjidhjen e problemit maqedonas dhe nuk kontribon në stabilizim të Ballkanit. Ashtu ishte në të kaluarën dhe ashtu do të jetë në të ardhmen. Zgjidhja e vetme e cila i pranon maqedonasit dhe i respekton të drejtat e tyre nacionale do të ishte zgjidhja e vetme dhe do të kontribonte paqes dhe stabilitetit në Evropën Juglindore.

Sygjerim:

- Maqedonia nuk mund të pranojë ndryshime në emrin e vet personal dhe identitetin. Bashkësia ndërkombëtare nuk guxon që vazhdimisht ta përkrahë nacionalizmin grek, nëpërmjet kundërshtimit të identitetit maqedonas. Ajo vetëm dëmton stabilitetin e Maqedonise dhe rajonit.
- Qeveria e Maqedonisë duhet ti ndërpresë negociatat në Kombet e Bashkuara dhe të kërkojë rezolutë të re e cila do të vërtetjë e emrit kushtetues të Maqedonisë në Kombet e Bashkuara

Si alternative

- Maqedonia duhet të kërkojë nga Kuvendi i Përgjithshëm ta parashtrojë para Gjyqit Ndërkombëtarë ligjshmërinë e rezolutës 47/225 (1993) dhe Rezolutës 817 (1193) të Këshillit të Sigurisë , më skatësisht pjesët e tyre të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e kushteve shtesë Maqedonisë në raport me emrin e saj dhe pranimit për anëtarim në Kombet e Bashkuara (më saktë kompatibilitetin e tyre me dispozitat e nenit 4 (1) nga Deklerata)¹⁵
- Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian duhet ta përkrahin njërën nga këto alternative me çrast nacionalizmin grek do ta sjellin pozit në *fait accompli* .Kjo zgjidhje e emrit gjithashtu do ta ndihmonte ruajtjen e dinjitetit të Greqisë
- Maqedonia nuk guxon ta humb emrin e vet dhe duhet të vazhdojë reformat socio-ekonomike të cilat kanë për qëllim anëtarim në NATO dhe Bashkimin Europian.

15 Како што тврди господинот Јанев, Генералното Собрание „не може да го опструира таквото барање пред Судот да се покрене барање за советодавно мислење бидејќи бараното мислење се однесува на законитоста на неговите сопствени акти. Таквата опструкција (од било кои причини) во суштина ќе значи дека Генералното собрание, како политичко тело, дава сопствен одговор за законитоста на сопствените акти или воведување на сопствен став во случај во кој тој самиот е страна (претставувајќи ја организацијата). Ова нема да биде компатибилно со основниот законски принцип на правна еднаквост и добра волја како и со мисијата и задачата на организацијата на Обединетите нации во однос на почитувањето на меѓународното право“. Види „ Правната одговорност на Обединетите нации поради незаконскиот прием на Македонија во членство на Обединетите Нации“, *Macedonian Affairs* 3 (1): стр 83, 2001 година.